



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 24 Mars 2023

Nr: 199

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMEVE, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE PËR
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 24 Mars 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

Qendra “Qendresa Qytetare”

Partia Demokratike, Dega Elbasan

SUBJEKT: Zj. Xheni Kita, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Korçë

Z. Shkëlqim Beqiraj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Patos

Z. Genci Floqi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Maliq

Z. Etjola Çato, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës

Zj. Elona Boriçi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionin e Entit Kombëtar të Banesave

Z. Mustafa Çarçiu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Belsh

Z. Dëfrim Korbi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kukës

Z. Nertil Nebiaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Gjirokastër

Zj. Diana Dervishi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionin e Autoritetit të Konkurrencës
Z. Alban Dokushi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tiranë
Z. Erjon Lalaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kavajë
Zj. Erisa Qalliu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Lushnjë
Zj. Manushaqe Gojka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
Zj. Ermelinda Pema, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Ministrisë së Shtetit për Standardet dhe Shërbimet
Z. Flauers Shoshi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta
Zj. Ogerta Manastirliu, Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Z. Gledian Llatja, Kryetar i Bashkisë, Elbasan
Z. Çelik Leka, Drejtor i Përgjithshëm pranë Ujësjetës Kanalizimeve, Elbasan
Z. Irland Sina, Drejtor i Përgjithshëm pranë Operatorit Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Elbasan
Z. Ermir Çela, Drejtor pranë Zyrës Vendore Arsimore, Elbasan
Z. Arben Asllanaj, Drejtor i Përgjithshëm pranë Uzinës së Lëndëve Plasëse Mjekës, Elbasan
Zj. Ermira Urupi, Drejtor i Përgjithshëm pranë Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Elbasan
Z. Julian Senia, Drejtor i Përgjithshëm pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Elbasan
Zj. Marsida Hyseni, Drejtor i Përgjithshëm pranë Drejtorisë Rajonale të Punësimit dhe Aftësisë, Elbasan

OBJEKT: Shqyrtim administrativ për shkelje në kundërshtim me nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Data: 24 Mars 2023

Nr: 199
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë indicie për organizimin e 39 (tridhjet e nëntë) veprimtarive publike, nga 24 (njëzetë e katër) institucione publike, për të cilat pretendohet se bien në kundërshtim me parashikimet e neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Indiciet janë marrë nëpërmjet provave, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur 39 (tridhjet e nëntë) indicie nga 3 (tre) subjekte të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me pretendimet e denoncuesve.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike email, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Subjektet objekt i këtij vendimi kanë paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

- 1- Bashkia Korçë**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 3 (tre) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 98, 99, 135 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:
 - Denoncimi **nr. 98 ID** *“Bashkë me përfaqësues të kompanisë më të madhe të gazit në Azerbajjan SOCAR dhe drejtues të kompanisë shqiptare të gazit ALBGAZ, zhvilluam sot një sërë takimesh konsultative me përfaqësues të shoqërisë civile, biznese, policinë dhe industrinë që operojnë në Bashkinë Korçë, si një prej komponentëve më të rëndësishëm për vazhdimësinë e këtij projekti.*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=741996623958332&set=pcb.741998573958137>

- Denoncimi nr. 99 ID "Mirëprita në bashki atletët e klubit shumësportësh në përfundim të Kampionatit Kombëtar Dimëror. Djem dhe vajza shumë të talentuar me ambicie dhe dëshirë për të realizuar ëndrrat e tyre.

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=5800349473381496&set=pcb.5800375536712223>

- Denoncimi nr. 135 ID "Hapet në Korçë Albania ICT Academy, akademia më e madhe për fëmijë në Shqipëri! E prezantuar këtë projekt të rëndësishëm në Shkollën 9-vjeçare "Stavri Themeli".

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=752361339588527&set=pcb.752361752921819>

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tyre, bashkia Korçë, nëpërmjet email-it ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: "...për arsye se nuk dispononim kredencialet për të raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, kemi bërë raportimin e këtyre veprimtarive nëpërmjet email: info@kqz.gov.al. Bashkia Korçë ka vënë në dispozicion të KQZ, kopje të e-mail të dërguar për raportimin e veprimtarive të mësipërme.

Në vijim të hetimit administrativ, Bashkia Korçë është njoftuar për zhvillimin e seancës publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, më datë 15 Mars 2023. Në seancë nuk pati përfaqësues të këtij institucioni.

Nga verifikimi i të dhënave, rezultoi se bashkia Korçë, ka përmbushur detyrimin për raportim për aktivitetet objekt denoncimi, nëpërmjet postës elektronike. Përsa më sipër, vlerësoj se veprimtaria e bashkisë Korçë, nuk përmban elemente për konstatimin e shkeljes, sipas përcaktimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor.

- 2- **Bashkia Patos**, ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **regjistruar me nr. 147 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- "Bashkia Patos ka raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, zhvillimin e një aktiviteti me temë "Inspektimi i Punimeve të Çerdhes së Qytetit", në këtë link <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/02/22/inspektimi-i-punimeve-te-cerdhes-se-qytetit-3/>. Sipas raportimit në këtë "Inspektim/kontroll" janë parashikuar se "Pjesëmarrësit" do të jenë: "Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve, Operatori Zbatues dhe Mbikqyrësi i Punimeve dhe Deputete të Kuvendit sipas dëshirës". Kjo e fundit lë të nënkuptojë se Bashkia i ka ftuar deputetët e Kuvendit për të marrë pjesë në këtë inspektim/kontroll. Ndërkohë, sipas raportimit njoftohet se aktiviteti nuk është i hapur për publikun dhe nuk do të mediatizohet.

Aktiviteti është raportuar për t'u kryer në datën 27 Shkurt 2023. Nga konsultimi i faqes së Facebook të Bashkisë Patos, duket se ky aktivitet nuk është publikuar në këtë faqe. Ndërkohë ky aktivitet është publikuar në datën 1 Mars 2023 në faqen e Facebook të deputetit Taulant Balla. Postimi i bërë ka këtë përmbajtje: "Patos Vijon puna për rikonstruksionin total të

çerdhes së qytetit në lagjen "Naftëtari". Çerdhja e re, e cila së shpejti do të presë vogëlushët e #Patosit është rehabilituar sipas të gjitha standardeve bashkëkohorë #ShqipëriaeArdhmjaJonëAL #Të BashkuarJo Të Ndarë #SkaKohëPërPushim" Postimi video, deri në ditën e dërgimit të këtij raporti, rezulton se është parë 9200 herë, ka marrë 1200 pëlqime, i janë bërë 241 komente, si dhe është shpërndarë 127 herë në faqe apo profile të tjerë të përdoruesve të facebook.

Prova link:

<https://www.facebook.com/b.taulant/videos/3339099476307206/>

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tij, bashkia Patos, nëpërmjet email-it të datës 8.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se:

"...Bashkia Patos, më datë 22 shkurt 2023, ka raportuar konform ligjit dhe brenda afateve të parashikuara. Në këtë aktivitet nuk ka ftuar asnjë deputet, por ka qenë i hapur për pjesëmarrjen e tyre. Përsa i përket pretendimit se Bashkia Patos nuk e ka publikuar këtë inspektim ndërkohë që z. Tauland Balla e ka publikuar në faqen e tij në Facebook, ju sqarojmë se në asnjë ligj apo udhëzim të Republikës së Shqipërisë nuk përcaktohet se aktivitetet duhet të publikohen në ditën kur ato kryhen. Pjesëmarrës në aktivitet kanë qenë: Kryetarja e bashkisë, stafit të Drejtorisë së Shërbimeve, Operatori Zbatues, Mbikqyrësi i Punimeve dhe dhe janë bashkëngjitur edhe Deputetët Taulant Balla dhe Antoneta Dhima. Inspektimi nuk ka qenë mediatik".

Pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve, vlerësoj se aktiviteti është raportuar konform parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu, aktiviteti i kryer nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, pasi zj. Rajmonda Balilaj ka qenë në kryerjen e detyrave të saj funksionale. Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve dhe nga këqyrja e materialit filmik, nuk rezulton që në këtë aktivitet janë mbajtur deklarime apo thirrje elektorale nga asnjë prej pjesëmarrësve. Pjesëmarrja e deputetit jo domosdoshmërisht e kthen aktivitetin e një institucioni publik, në një aktivitet elektorale. Fjalimi me përmbajtje elektorale, logot, materialet propagandistike dhe çdo element tjetër, që mbart mesazhe elektorale, janë elementë që e kthejnë aktivitetin në të tillë. Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Patos, nuk përbën në shkelje të neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

- 3- Bashkia Maliq**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 14 (katërmëdhjetë) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 71, 72, 73, 100, 101, 102, 115, 116, 117, 118, 119, 136, 140, 142 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:
- Denoncimi **nr. 71 ID** *"Bashkia Maliq gati për një bashkëpunim të dytë me Korça Hub dhe nxënës të sistemit parauniversitar. Në fokus të takimit: Shërbime për studentët me qëllim zhvillimin e aftësive të rinjve dhe rritjen e kapacitetit të tyre për t'iu përshtatur epokës digjitale dhe kërkesave të tregut të punës me profesionalizëm."*

Data: 24 Mars 2023

Nr: 199
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike"

Prova Link

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=5777210372362073&set=pcb.5777221079027669>

- Denoncimi nr. **72 ID** "Nga puna për riparimin e urës së Ormanit mbi Lumin Devoll"

Prova Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=5776500282433082&set=pcb.5776502172432893>

- Denoncimi nr. **73 ID** "Këtë mëngjes në Pirg duke parë në vend e njohur me shqetësimet e banorëve."

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=5776157885800655&set=pcb.5776163419133435>

- Denoncimi nr. **100 ID** " Këtë mbrëmje në Plasë duke biseduar për shqetësime të ndryshme të banorëve."

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=5800349473381496&set=pcb.5800375536712223>

- Denoncimi nr. **101 ID** "Me një grup të rinjsh nga Pojani dhe Pirgu, për të diskutuar mbi sfidat e së nesërme. Vlerësime për investimet e realizuara në arsim dhe infrastrukturë, por ende kërkohen më shumë projekte për të rinjtë, kulturën e sportin."

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=5799910896758687&set=pcb.5799955206754256>

- Denoncimi nr. **102 ID** "Nga takimet në Maliq e Kakaç. Vlerësim për punët e realizuara në të gjithë territorin, optimizëm për investime të tjera në vazhdimësi"

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=5790384924377951&set=pcb.5790394511043659>

- Denoncimi nr. **115 ID** "Nga inspektimi punimeve në rrugën kryesore Pirg e Zvirinë".

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=5825498200866623&set=pcb.5825504930865950>

- Denoncimi nr. **116 ID** "Podgorie-Nj.Ad.Vreshtas. Në lagjen lart duke diskutuar me banorët për problematika të lagjes dhe fshatit".

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=5819828711433572&set=pcb.5819833628099747>

- Denoncimi nr. **117 ID** "Me të rinjtë e Libonikut në një bashkëbisedim mbi sfidat e të ardhmes".

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=5819419098141200&set=pcb.5819430904806686>

- Denoncimi nr. **118 ID** "Në Pirg, po punojmë për mbylljen e hyrjes kryesore, duke e kthyer në një rrugë me standarde dhe gjithë elementët e domosdoshëm".
Prova link:
<https://www.facebook.com/photo/?fbid=5812231015526675&set=pcb.5812240572192386>
- Denoncimi nr. **119 ID** "Takim me të rinjtë në Maliq! Kërkesat e tyre janë për programe të ndryshme, teknologjinë, sportin, kulturën etj. Me të rinjtë qyteti dhe bashkia është krejt ndryshe".
Prova link:
<https://www.facebook.com/photo/?fbid=5809646399118470&set=pcb.5809655495784227>
- Denoncimi nr. **136 ID** "Një takim i rastësishëm me banorë të fshatit Orman. Diskutime për problematika e punë të tjera që do të realizojmë shumë shpejt në këtë fshat. Puna e jonë nuk është me fushata , ne kemi treguar që punojmë çdo ditë."
Prova link:
<https://www.facebook.com/photo/?fbid=5839540549462388&set=pcb.5839564062793370>
- Denoncimi nr. **140 ID** "Me të rinj nga lagjia Qesarat e Pirg për sfidat e të ardhmes. Me ju ndjehesh më i ri e patjetër më optimist.
Prova Link
<https://www.facebook.com/photo/?fbid=5842675645815545&set=a.324020337681131>
- Denoncimi nr. **142 ID** "Këtë mbasdite në Burimas për të vlerësuar njerzit e punës, e për tu njohur edhe me shqetësime të vet banorëve.
Prova link:
<https://www.facebook.com/photo/?fbid=5849344508481992&set=pcb.5849371651812611>

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tyre, bashkia Maliq, nëpërmjet email-it ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: "ju bëjmë me dije se Bashkia Maliq, në bazë të shkresës nr. 3874 prot., datë 2.12.2022 ju ka kthyer përgjigje me shkresën zyrtare nr. 6071/1 prot. datë 9.12.2022, nëpërmjet së cilës ju informojmë në lidhje me personin e kontaktit me institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Deri më sot nuk kemi pasur akses në ndërfaqen e Komisionit Qendroro të Zgjedhjeve, pasi nuk disponojmë kredencialet për të bërë raportimet në faqen zyrtare. Në lidhje me veprimtaritë publike që parashtroni në e-mail janë bërë raportimet përkatëse por për shkak të mungesës së aksesit nuk janë publikuar në faqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në vijim të hetimit administrativ, Bashkia Maliq është njoftuar për zhvillimin e seancës publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, më datë 15 Mars 2023. Në seancë nuk pati përfaqësues të këtij institucioni.

Pasi u njoha me faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive, jashtë vullnetit të organit publik. Bashkia Maliq është pajisur me kredencialet përkatëse për log-in në faqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në datën 28.2.2023.

Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, dhe veprimtaritë nuk përbëjnë veprimtari të ndaluara referuar nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

4- Prefekti i Qarkut Durrës, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **regjistruara me nr. 132 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 132 ID** "*Sot, Prefekti Qarkut Durrës Z. Emiljan Jani, në cilësinë e Kryetarit të Komitetit Rajonal Anti Trafik, zhvilloi analizën e veprimtarisë së këtij Komiteti për vitin 2022. Në këtë mbledhje analize ishin të pranishëm të gjithë strukturat shtetërore dhe organizatat jo qeveritare anëtare të këtij komiteti*"

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=576762437826588&set=pcb.576758527826979>

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tij, Prefekti i Qarkut Durrës, nëpërmjet email-it të datës 7.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se:

"Në zbatim të urdhërit të kryeministrit nr. 06, datë 26.1.2017 "Për krijimin e Komitetit Rajonal të Luftës kundër trafikimit të personave në çdo qark" dhe "Rregullores për funksionimin e Komitetit Rajonal të Luftës kundër trafikimit të personave në çdo qark" ku Komiteti Rajonal Antitrafik (KRAT) duhet të mblidhet jo më pak se një herë në tre muaj, Prefekti në cilësinë e Kryetarit të KRAT ka vijuar detyrën e caktuar në ligj për veprimtarinë e këtij komiteti. Në datën 9.2.2023, ora 10.00 është zhvilluar takimi i radhës për analizën e veprimtarisë së Komitetit Antitrafik për vitin 2022. Kjo mbledhje u organizua nga Prefekti i Qarkut në cilësinë e Kryetarit të KRAT me pjesëmarrës: Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit, bashkia Durrës, bashkia Krujë, bashkia Shijak, Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror, Zyra Vendore Arsimore Durrës, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës, Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore si dhe World Vision".

Në vijim të hetimit administrativ u njoftua përfaqësuesi i Prefektit të Qarkut Durrës, për të marrë pjesë në seancën publike dëgjimore të datës 15 Mars 2023. Gjatë seancës, përfaqësuesi i Prefektit të Qarkut Durrës, deklaroi ndër të tjera se institucioni, gjatë periudhës kur është zhvilluar aktiviteti nuk ka qenë i pajisur me kredencialet për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, veprimtaria publike e kryer nga subjekti është në kuadër të

përbushjes së detyrave të tij funksionale, nuk përbën veprimtari publike të ndaluar dhe për rrjedhojë, nuk kemi përdorim të burimeve publike, në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Gjithashtu, pas njohjes me rrethanat dhe faktet, vlerësohet se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive, jashtë vullnetit të organit publik. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësoj se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

5- Enti Kombëtar i Banesave, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **regjistruar me nr. 144 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi me **nr. 144 ID** *“Ditën e sotme Drejtori i Përgjithshëm z. Stefan Çipa ka realizuar inspektimin në kantierin e ndërtimit të objektit në qytetin e Burrelit. Punimet po ecin me ritme të shpejta, me qëllim strehimin sa më parë të 25 familjeve.*

Prova Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=1980364782306701&set=pcb.1980376235638889>

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tyre, Enti Kombëtar i Banesave, nëpërmjet email-it të datës 7.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Aktiviteti nuk është organizuar si veprimtari publike, por thjesht si një kontroll dhe vizitë rutinë në kantier në kuadër të veprimtarisë së institucionit dhe detyrave funksionale të titullarit. Vizita në kantier është bërë në datën 1.3.2023, në orën 12.00 në qytetin e Burrelit me qëllim mbikqyrjen e ecurisë së punimeve me pjesëmarrës drejtuesin e institucionit dhe përfaqësues nga shoqëria sipërmarrëse që po zhvillon projektin e ndërtimit të objektit në qytetin e Burrelit. Nuk ka patur pjesëmarrës nga shoqëria civile dhe publikimi në faqen e institucionit nuk është bërë me idenë e veprimtarisë publike, por si rutinë e prezantimit të përbushjes së veprimtarisë së institucionit”.*

Në vijim të hetimit administrativ u njoftua përfaqësuesi i Entit Kombëtar të Banesave për të marrë pjesë në seancën publike dëgjimore të datës 15 Mars 2023, gjatë së cilës risolli në vëmendje natyrën e këtij aktiviteti duke theksuar se aktiviteti s’ka qenë publik dhe ka qenë në përbushje të detyrave institucionale.

Referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, u konstatua se veprimtaria publike e kryer nga subjekti nuk përbën veprimtari publike të ndaluar, por është në përbushje të detyrave të institucionit dhe për rrjedhojë, nuk kemi përdorim të burimeve publike, në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Në këto kushte, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ.

6- Bashkia Belsh, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **regjistruar me nr. 122 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- *“E nisëm me kafën e mëngjesit në shtëpinë e Sopotit! Bashkëbisedim i ngrohtë mes njerëzve të punës!”.*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=645568277576552&set=pcb.645568310909882>

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tyre, bashkia Belsh nuk është përgjigjur brenda afatit.

Në vijim të hetimit administrativ u njoftua përfaqësuesi i bashkisë Belsh, për të marrë pjesë në seancën publike dëgjimore të datës 15 Mars 2023. Gjatë seancës, përfaqësuesi i bashkisë Belsh, deklaroi ndër të tjera se aktiviteti është zhvilluar në datën 22.2.2023. Pajisja me kredencialet e raportimit është bërë e mundur po në datën 22.2.2023. Pra, gjatë periudhës kur është zhvilluar aktiviteti bashkia nuk ka qenë e pajisur me kredencialet për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Pasi u njoha me faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive, jashtë vullnetit të organit publik.

Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësoj se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

7- Bashkia Kukës, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 4 (katër) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 23, 24, 25, 26 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 23 ID** "*Me banorët e fshatit Malqene të Njesisë Administrative Ujmisht, folëm për punët që kemi bërë e që do bëjmë në vazhdimësi*"

Prova Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=731952011625936&set=pcb.731955144958956>

- Denoncimi **nr. 24 ID** "*Me banorët e fshatit Lusën të Njesisë Administrative Ujmisht, folëm për punët që kemi bërë e që do bëjmë në vazhdimësi*"

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=732387231582414&set=pcb.732390284915442>

- Denoncimi **nr. 25 ID** "*Kënaqësi të mirëprisja një pjesë të stafit të gjimnazit "Havzi Nela" bashkë me një grup nxënësish të klasave të 11-ta*"

Prova Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=733755301445607&set=pcb.733756264778844>

- Denoncimi **nr. 26 ID** "*Sot me banorët e Gostilit diskutuam rreth punëve që kemi bërë e do vazhdojmë të bëjmë.*"

Prova Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=734660598021744&set=pcb.734660734688397>

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tyre, bashkia Kukës, nëpërmjet e-mail-it të datës 7.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: "*Bashkia Kukës, nuk ka qenë e pajisur me kredenciale në momentin e zhvillimit të aktiviteteve*".

Në vijim të hetimit administrativ u njoftua përfaqësuesi i bashkisë Kukës, për të marrë pjesë në seancën publike dëgjimore të datës 15 Mars 2023, por nuk u paraqit asnjë përfaqësues.

Pasi u njoha me rrethanat dhe faktet, vlerësoj se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive, jashtë vullnetit të organit publik. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësoj se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

8- **Bashkia Gjirokastrë**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 3 (tre) veprimtari publike, të regjistruara me nr. **56, 86, 87 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. **56 ID**, *“Kënaqësi të prisja në vizitën e saj të parë në Gjirokastrë, ambasadorën e Zvicrës, Ruth Huber, për një bisedë shumë të mirë mbi punët që kemi bërë e të tjera që presim të finalizojmë”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=887973722580903&set=pcb.8879737459142>

- Denoncimi nr. **86 ID**, *“Musineja e qytetit tim” titullohej aktiviteti i organizuar nga Bashkia Gjirokastrë në 106-vjetorin e lindjes së publicistes, studiueses dhe disidentes, Musine Kokalari. Programi i aktivitetit përfshinte njohjen me jetën dhe kontributin e saj, interpretimin e pjesëve nga krijimtaria letrare, etj.”*

Prova

link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=563986869095419&set=pcb.563987025762070>

- Denoncimi nr. **87 ID**, *“Prezantuar thirrjen e Ministrisë së Kulturës për Fondin e Artizanëve 2023. Mbështesim traditën e zejtarisë dhe punimeve karakteristike si mundësi e mirë për të ruajtur identitetin dhe zhvilluar turizmin.”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=898600538184888&set=pcb.898600814851527>

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tyre, jemi informuar se për denoncimin nr. 32 dhe 56 ID, bashkia Gjirokastrë nuk ka qenë organizator i aktivitetit. Përsa u përket denoncimeve me nr. 86 dhe 87 ID, nëpërmejt shkresës nr. 1788 prot., datë 22.02.2023, jemi informuar se bashkia Gjirokastrë, në momentin kur janë zhvilluar aktivitetet nuk ka qenë e pajisur me kredenciale për aksesimin e ndërfaqes. Referuar të dhënave që disponon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bashkia Gjirokastrë është pajisur me kredenciale në datën 21.2.2023.

Referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, u konstatua se veprimtaritë publike të kryera nga subjekti nuk përbëjnë veprimtari publike të ndaluara.

Përsa më sipër, pas njohjes me rrethanat dhe faktet, vlerësoj se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive, jashtë vullnetit të organit publik. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësoj se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

- 9- **Autoriteti i Konkurrencës** nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **regjistruar me nr. 74 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:
- Denoncimi **nr. 74 ID**, *“Në datën 24 Janar 2023, në ambientet e Rogner Hotel Tirana u zhvillua një takim me qëllim simulimin e aktivitetit që do të zhvillohet përpara Komisionit Evropian. Fokusi kryesor i këtij takimi ishte parapërgatitja për një përfaqësim sa më të mirë të Autoritetit të Konkurrencës në Takimin Bilateral Screening.”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=548873523934460&set=pcb.548874183934394>

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tij, Autoriteti i Konkurrencës, nëpërmjet shkresës së datës 15.3.2023 bën me dije se:

“Autoriteti i Konkurrencës mori pjesë në këtë aktivitet në kuadër të takimit Bilateral Screening, i cili u zhvillua në datat 6, 7 dhe 8 Mars 2023 në Bruksel nga Komisioni Evropian. Fokusi kryesor i këtij takimi ishte parapërgatitja e një përfaqësimi sa më të denjë të Autoritetit të Konkurrencës në takimin Bilateral Screening në kuadër të procesit të intergimit Evropian pas hapjes së negociatave me Shqipërinë.”

Në vijim të hetimit administrativ u njoftua përfaqësuesi i Autoritetit të Konkurrencës, për të marrë pjesë në seancën publike dëgjimore të datës 15 Mars 2023, gjatë së cilës risolli në vëmendje natyrën e këtij aktiviteti, duke ritheksuar se veprimtaria nuk ka qenë publike, por është në përmbushje të detyrave të institucionit.

Referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, u konstatua se veprimtaria publike e kryer nga subjekti nuk përbën veprimtari publike të ndaluar, por është në përmbushje të detyrave funksionale të institucionit dhe për rrjedhojë, nuk kemi përdorim të burimeve publike, në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Në këto kushte, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ.

- 10- **Bashkia Tiranë**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2 (dy) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 5 dhe 10 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 5 ID** *“Rikonstruktohet gjimnazi “Besnik Sykja”/ Veliaj: Po shfrytëzojmë çdo hapësirë për fëmijët që duan të merren me sport.”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/bashkia.tirane.al/videos/1326753011202107/>

- Denoncimi **nr. 10 ID** *“Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj ishte sot pjesë e tryezës “Tirana City Talks”, me urbanistë e arkitektë, të cilët diskutuan për ndërtimet dhe hapësirat publike, se si ato ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve”.*

Prova link:

<https://www.facebook.com/bashkia.tirane.al/videos/837475843982384/>

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tyre, nuk është paraqitur asnjë kthim përgjigje nga ana e bashkisë Tiranë. Nga verifikimi i

ndërfaqes rezultoi se për denoncimin nr. 5 ID, është bërë raportimi në ndërfaqen e KQZ sipas link <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/01/13/inspektim-punimesh/> dhe për denoncimin nr. 10 ID është bërë raportimi në ndërfaqen e KQZ sipas link <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/02/10/takim-7/>.

Përsa më sipër, vlerësoj se veprimtaria e Bashkisë Tiranë, nuk përmban elemente për konstatimin e shkeljes, së nenit 92, të Kodit Zgjedhor.

11- Bashkia Kavajë, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2 (dy) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 89 dhe 125 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 89 ID**, *“Kënaqësi të mirëprisja në zyrë përfaqesuesit e Unionit të Sipërmarrësve të rinj të Shqipërisë (YAEU) në kuadër të projektit Aftësim dhe Punësim për të rinjtë projekt i mbështetur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) dhe Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me Dhomën e Biznesit të Diasporës Shqiptare (ADBC)”*.

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=589554092990009&set=pcb.58955451965>

- Denoncim **nr. 125 ID**, *“Takim me banorë në Helmas. Kavaja është e çdo banori të saj, qytet a njësi qoftë. Është e njerëzve të ndershëm dhe punëtorë që duan të kontribuojnë në transformimin e mëtejshëm të saj.”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=597520338860051&set=pcb.597520685526683>

Nga verifikimi i informacioneve, rezultoi se të dhënat e denoncimit **nr. 125 ID**, përmban të njëjtat fakte dhe rrethana për të cilat Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, është shprehur me vendimmarrje nëpërmjet vendimit nr. 86, datë 3 Mars 2023. Përsa më sipër, nuk mund të vazhdoj me hetimin e rastit të objekt denoncimi.

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tij, bashkia Kavajë ka dërguar pretendimet e saj nëpërmjet email-it të datës 10.3.2023, nëpërmjet të cilit pretendon se për denoncimin **nr. 89 ID**, bashkia Kavajë nuk ka qenë organizatori i këtij takimi, i cili pavarësisht të gjithave ka qenë një takim i mbyllur me grupet e interesit dhe jo mediatik.

Në vijim të hetimit administrativ u njoftua përfaqësuesi i bashkisë Kavajë për të marrë pjesë në seancën publike dëgjimore të datës 15 Mars 2023, gjatë së cilës, risolli në vëmendje natyrën e këtij aktiviteti dhe pamundësinë për të aksesuar ndërfaqen për shkak të mungesës së kredencialeve.

Pasi u njoha me faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se organi publik, nuk ka qenë në cilësinë e organizatorit të aktivitetit si dhe në kushte të mundësisë për të raportuar, duhet mirëkuptuar situata dhe duhet të pushohet hetimi administrativ.

12- Bashkia Lushnje, ka raportuar me vonesë në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2 (dy) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 148 ID** të zhvilluar më datë 27.2.2023 dhe 1.3.2023 për të cilën pretendohet si vijon: *“Bashkia Lushnjë ka raportuar*

në ndërfaqen e KQZ kryerjen e disa vizitave në ferma në datën 28 shkurt dhe 1 mars 2023, të cilat jepen në linqet e mëposhtme:

<https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/02/24/vizite-te-ferma-e-vellezerve-julian-dhe-klodian-shani/>

<https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/02/23/vizite-ne-seren-e-z-edi-shtembari-fshati-zhelizhan/>

<https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/02/23/vizite-ne-seren-e-z-renato-shtembaritfshati-zhelizhan/>

<https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/02/23/vizite-ne-seren-e-ilir-shtembaritfshati-zhelizhan/>

<https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/02/23/vizite-ne-piken-e-grumbullimit-e-z-allkanjari-ne-krutje/>

Për të gjitha aktivitetet e mësipërme raportohet prej Bashkisë Lushnje se "Folësit kryesorë" do të jenë Eriselda Sefa dhe Taulant Balla, për të cilët deklarohet edhe "Pozicioni", respektivisht "Kryetar i Bashkisë Lushnje | Drejtues Politik". Sipas raportimit njoftohet se aktiviteti nuk është i hapur për publikun dhe nuk do të mediatizohet. Nga kontrolli i bërë, rezultoi se asnjë prej këtyre aktiviteteve nuk është publikuar në mediat sociale të Bashkisë Lushnje. Ndërkohë, referuar faqes së Facebook-ut të deputetit Taulant Balla, ai ka qenë i pranishëm në së paku dy prej tyre, së bashku me kryetaren e bashkisë Lushje:

"Vizite ne piken e grumbullimit e z. Allkanjari ne Krutje...".

Më datë 6.3.2023 bashkisë Lushnje i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 10.3.2023, bashkia Lushnje sqaron dhe bën me dije se "<https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/02/14/vizite-te-ferma-e-vellezervejulian-dhe-klodian-shani/>; <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/02/23/vizite-ne-piken-e-grumbullimit-e-z-allkonjari-ne-krutje>

Për të dyja aktivitetet e mësipërme raportimi nga ana jonë i të dyja vizitave, njëra në një fermë dhe tjetra në një pikë grumbullimi të frutave dhe perimeve në Njësinë Administrative Krutje është bërë në datën 28 Shkurt, sipas ftesës. Për arsyen familjare të kryetares së bashkisë zj. Eriselda Sefa këto vizita u kryen në datën 27 Shkurt me mirëkuptimin e të dy administratorëve të subjekteve. Nga ana jonë raportimi u bë, sipas ftesës, brenda rregullave dhe afateve të përcaktuara sipas udhëzimit, por gjatë përditshmërisë ka edhe të papritura.

Nga ana e Institucionit të bashkisë Lushnje është respektuar raportimi dhe nuk janë publikuar në mediat sociale të bashkisë Lushnje asnjë prej vizitave të mësipërme. Ju bëjmë me dije se janë vizita në dy subjekte private, ftesë e bërë nga dy administratorët e subjekteve përkatesisht në piken e grumbullimit të z. Saimir Allkanjari dhe në fermë nga z. Klodian Shani. Për këtë arsye ju sqarojmë se është vizitë jo aktivitet i hapur për publikun. Siç edhe është pohuar nga kontrolli i bërë, edhe nga ankuesi ka rezultuar se asnjë prej këtyre aktiviteteve nuk është publikuar në mediat sociale të bashkisë Lushnje.

Na mirekuptoni nuk është përgjegjësi e jona cfarë publikohet ne faqen personale të z. Taulant Balla. Takimi u zhvilluan në datën 27 Shkurt, në oraret ora 11:00 në fermën e z.Klodian Shani dhe ora 14:30 në pikën e grumbullimit të z.Allkanjari.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se veprimtaritë objekt denoncimi, janë të raportuara në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ato janë vlerësuar si veprimtari të lejuara për tu zhvilluar. Për dy veprimtaritë e tjera, të zhvilluara para datës së raportuar në ndërfaqen e raportimeve, vlerësoj se fakti që veprimtaritë e kryera nuk përbëjnë veprimtari të ndaluara në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, dhe ndryshimet në agjendën e kryetares së bashkisë kanë ardhur për arsye subjektive, duhet të mirëkuptohet situata dhe të pushohet hetimi administrativ.

13- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 13 ID** për të cilën pretendohet si vijon:

“Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator. Denoncuesi pretendon si më poshtë vijon: "Sipërmarrja, Standartet dhe Shërbimet. Arritje, sfida.”

Link: <https://www.facebook.com/st+andardetesherbimeve/videos/1020687602222781>

Më datë 16.2.2023 Ministrin të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike.

Me shkresën nr. 833 prot., datë 17.2.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 925 prot., datë 17.2.2023, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes sqaron dhe bën me dije se *“...ka marrë njoftimin nga Agjencia për Media dhe Informim për organizimin e Konferencës për Shtyp me datë 19.01.2023, ora 11:00, në ambientet e COD në Kryeministri. Kjo konferencë për shtyp organizohej në kuadër të raportimit të anëtarëve të Këshillit të Ministrave mbi ecurinë institucionale për vitin 2022 dhe për sfidat përkatëse për vitin 2023. Në këtë Konferencë për Shtyp, ishin pjesëmarrës ministrat e shtetit znj. Edona Bilali dhe znj. Milva Ikonomi..”*

Së pari, evidentojmë që organizimi në fjalë ishte Konferencë për Shtyp me praninë e mediave dhe pa pjesëmarrjen e publikut. Për rrjedhojë, Konferenca për Shtyp vlerësohet si një dalje publike dhe një organizim i ngjashëm me dhënien e një interviste për mediat. Së dyti, theksojmë se referuar shkresës tuaj nr. 3873 prot., datë 02.12.2022, kërkohej caktimi i personit të kontaktit për raportimin e veprimtarive.

Më pas, KQZ në adresën e e- mail të personit të kontaktit do të dërgonte link-un dhe udhëzimet përkatëse me qëllim hapjen e llogarisë së institucionit tonë. Ju bëjmë me dije se pranë Kabinetit të Ministrat nuk janë përcjellë zyrtarisht nga ana e Komisionit Qendror kredencialet e llogarisë në platformën raportuese për personin e kontaktit. Këto kredenciale janë dërguar me e-mail pas një kërkesë verbale nga Kabineti i Ministrat të Shtetit më datë 18.01.2023, rreth orës 13:00, më pak se një ditë para organizimit në fjalë.”

Pas njohjes me përgjigjen dhe informacionet nga ana e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në vijim të procesit hetimor Agjencisë për Media dhe Informim i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike.

Me shkresën nr. 41/1 prot., datë 21.2.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 1064 prot., datë 23.2.2023 Agjencia për Media dhe Informim, sqaron dhe bën me dije se:

“Agjencia për Media dhe Informim është përgjegjëse për informimin e publikut dhe medias mbi komunikimet publike të qeverisë.

Nuk përbëjnë detyrim të Agjencisë për Media dhe Informim planifikimi dhe organizimi i veprimtarive publike të ministrive dhe agjencive nën varësinë e tyre, duke përfshirë ministrat e shtetit. Këto veprimtari realizohen nga institucionet përkatëse, të cilat vendosin mbi tematikën e veprimtarisë, përzgjedhin vendin, datën dhe orën e mbajtjes së tyre, përcaktojnë nivelin e pjesëmarrjes si për anëtarët e qeverisë, ashtu edhe për qytetarët dhe median. Agjencia për Media dhe Informim i mbështet këto institucione për nevojat e tyre lidhur me informimin e qytetarëve dhe medias mbi veprimtarinë në kanalet zyrtare të komunikimit publik. Veprimtaria në fjalë nuk është organizuar nga Agjencia për Media dhe Informim, por nga Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe me nismën e këtij institucioni..”.

Në mbështetje të procesit hetimor palët e përfshira në këtë proces u ftuan në seancën dëgjimore publike të datës 15.3.2022, ora 12:00, por nuk u paraqitën pa arsye të përligjura në këtë seancë.

Në përfundim të hetimit administrativ, pas njohjes me rrethanat dhe faktet, vlerësoj se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive, jashtë vullnetit të organit publik. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësoj se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

14- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes/ Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, të regjistruara me **nr. 70 ID** për të cilën pretendohet si vijon:

Ministrja Ekonomi bashkë me kolegen Edona Bilali zhvilluan një takim me drejtuesit e Unionit të Dhomave të Tregtisë dhe kryetarët e dhomave të biznesit të 12 qarqeve në vend. Informacioni që KRIIK disponon lidhur me këtë veprimtari publike është vetëm link-u që po ju vëmë në dispozicion:

<https://www.facebook.com/standardetesherbimeve/photos/pcb.154113967476085/154113047476177>

Për sa i përket takimit me drejtuesit e Unionit të Dhomave të Tregtisë dhe kryetarët e dhomave të biznesit, më datë 13.2.2023, Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike.

Me shkresën nr. 790 prot., datë 17.2.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 895 prot., datë 16.2.2023, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes sqaron dhe

bën me dije se *“Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka marrë njoftim nga Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve për organizimin e takimit të punës, në ambientet e Kryeministrit, me objekt parësor diskutimet mbi përmirësimin e klimës së të bërit biznes në Shqipëri. Kjo tematikë është pjesë e misionit të fushës së veprimtarisë të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Ky takim pune u zhvillua me datë 01/02/2023 ora 13:00, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, të kryetarëve të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë në vend, ministrat e shtetit zj. Milva Ekonomi dhe zj. Edona Bilali...”*

Pas njohjes me përgjigjen dhe informacionet nga ana e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në vijim të procesit hetimor Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 20.2.2023, Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve sqaron dhe bën me dije se *“Takimi është zhvilluar ditën e mërkurë datë 1.2.2023 në sallën rrethore kati i tretë në godinën e Kryeministrit.*

Fokusi i kësaj tryeze pune ishte përmirësimi i klimës së të bërit biznes në Shqipëri, mundësitë dhe nevojat që duhet të reflektojnë legjislacioni që rregullon këtë fushë. Si rrjedhojë, bazuar në Kodin Zgjedhor dhe shkresën e ardhur nga KQZ mbi veprimtarinë e institucioneve publike theksojmë, se bëhet fjalë për një tryezë diskutimi pune.”

Në mbështetje të procesit hetimor palët e përfshira në këtë proces u ftuan në seancën dëgjimore publike të datës 15.3.2022, ora 12:00, por nuk u paraqitën pa arsye të përligjura në këtë seancë.

Pas dërgimit të njoftimit nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve ka paraqitur edhe një herë pretendimet mbi zhvillimin e aktivitetit nëpërmjet postës elektronike. Në këtë komunikim pala shprehet se *takimi ka qenë i mbyllur pa praninë e mediave dhe jo i hapur për publikun. Pjesëmarrës ishin Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, përfaqësues të Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë dhe Kryetarë të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë në Vend. Fokusi i kësaj tryeze pune ishte përmirësimi i klimës së të bërit biznes në Shqipëri, mundësitë dhe nevojat që duhet të reflektojnë legjislacioni që rregullon këtë fushë.*

Referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, u konstatua se veprimtaria publike e kryer nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, nuk përbën veprimtari publike të ndaluar, por është takim pune në kuadër të detyrave funksionale të institucionit. Për sa kohë që takimi ishte i mbyllur, pa prezencë

të medias dhe vetëm me pjesëmarrje të grupit të punës ,vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ.

15- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 21 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- "Ujësjetllësi i ri i Belshit është pothuajse gati. Një projekt i ri, i integruar, i cili do të furnizohet me energji elektrike përmes paneleve fotovoltaike duke ulur në këtë mënyrë me 95% kostot e energjisë. Jo vetëm përmirësojmë cilësinë e furnizimit me ujë të pijshëm për qytetarët, por ulim edhe kostot. Një shembull që do ta aplikojmë edhe në zona të tjera".

Link:

<https://www.facebook.com/ministriaeinfrastrukturesdheenergjise/videos/589474706523077/>

Sipas denoncuesit veprimtaria publike rezulton të jetë transmetuar në 3 (tre) media publike".

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tij, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nëpërmjet email-it të datës 20.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se:

"Aktiviteti i përmendur nga ana juaj është organizuar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe trajtimit të mbetjeve në bashkëpunim me bashkinë Belsh.

Në vijim të hetimit administrativ, i është kërkuar informacion për të sjellë shpjegime për sa pretendohet nga denoncuesi, bashkisë Belsh dhe Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Trajtimit të Mbetjeve.

Në mbështetje të procesit hetimor palët e përfshira në këtë proces u ftuan në seancën dëgjimore publike të datës 15.3.2022, ora 12:00, të cilët parashtruan se kanë pasur probleme me pajisjen me kredenciale, prandaj nuk kanë mundur dot të bëjnë raportimin e veprimtarive publike, objekt denoncimi.

Në përfundim të hetimit administrativ, pas njohjes me rrethanat dhe faktet, vlerësoj se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive, jashtë vullnetit të organit publik. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësoj se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

16- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike **regjistruar me nr. 84 ID**, për të cilën

pretendohet se ka përdorim të burimeve publike në mbështetje të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” përmes mbështetjes dhe promovimit të investimeve në Spitalin e Lezhës.

Me nisjen e hetimit administrativ, me shkresën nr. 926 prot., datë 17.2.2023, zj. Ogerta Manastirliu Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, z. Ulsi Manja, z. Pjerin Ndreu kryetari i bashkisë Lezhë dhe z. Leon Kaza, Drejtor i Spitalit Rajonal Lezhë, i është kërkuar informacion mbi zhvillimin e aktivitetit të pretenduar nga denoncuesi.

Në vijim të kërkesës për informacion Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 936/1 prot., datë 22.2.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 926/1 prot., datë 22.2.2023 me sqarojnë dhe informojnë se:

“Ministria e Shëndetësisë është e angazhuar maksimalisht për raportimin në kohë dhe shterues të të gjitha aktiviteteve me karakter publik në përputhje me nenet 91 dhe 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar si dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Sa i përket aktivitetit të sjellë në vëmendje nga ana denoncuesit dhe pretendimit për mosraportimin e këtij aktiviteti në ndërfaqen e raportimeve në KQZ, sqarojmë se MSHMS në kuadër të përmbushjes së detyrimit për të raportuar çdo aktivitet me karakter publik, ka publikuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve këtë aktivitet, i cili vijon të jetë i publikuar aktualisht në Rubrikën "Veprimtaritë Publike" (Prova nr. 1 - Screenshot "Aktivitetet e Raportuara"), ku siç rezulton është bërë dy herë raportimi për këtë aktivitet: 1. Raportimi më datë 27.1.2023 për zhvillimin e aktivitetit më datë 3.2.2023; 2. Ripublikimi më datë 2.2.2023, për ndryshimin e datës së zhvillimit të aktivitetit (datë 07.02.2023).

Sqarojmë se ky aktivitet nuk ka qenë i hapur për publikun dhe nuk ka qenë me pjesëmarrjen e medias, por pasqyrohet në rrjetet sociale të Ministres, dhe është lehtësisht i aksesueshëm nga mediat dhe kushdo tjetër. Gjithashtu, theksojmë se promovimi i investimeve me fonde të vendosura në dispozicion përpara datës 13 Janar 2023, nuk përfshihet në kategorinë e veprimtarive të ndaluara të përcaktuara në vendimin e datës nr. 9, datë 24.12.2020, si dhe fjala e pjesëmarrësve në asnjë rast nuk ka pasur ngjyrimë partiake. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbetet në dispozicion për çdo informacion shtesë që mund të kërkohet nga ana e Institucionit tuaj.”

Në vijim të procesit hetimor, me shkresën nr. 215/2 prot., datë 24.2.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 926/2 prot., datë 27.2.2023, Spitali Rajonal Lezhë sqaron dhe informon se: “Ky takim është bërë me datë 7.2.2023, ora 9:00. Qëllimi i këtij takimi ka qenë me fokus të vazhdimësisë së investimeve të realizuara nga Ministria e Shëndetësisë në institucionin tonë, siç është prezantimi i projektit të ri për fillimin e investimit transformues të rikonstruksionit të godines qendrore të spitalit si dhe vënia në punë e aparaturës së re biomjekësore “Dexa” për matjen e densimetrisë kockore, e instaluar tashmë në shërbimin e imazherisë. Sqarojmë se ky aktivitet është organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk ka qenë i hapur për publikun dhe nuk ka qenë me pjesëmarrjen e medias, por është pasqyruar në rrjetet sociale të Ministrisë.”

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 15.3.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Të pranishëm në këtë seancë ishin përfaqësuesi i qendres "Qendresa Qytetare" z. Rigels Xhemollari dhe përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale z. Alma Dervishaj, të cilët mbajtën qëndrimet e tyre dhe dhanë sqarime lidhur me këtë proces administrativ.

Në seancën publike, përfaqësuesi i qendres "Qendresa Qytetare", z. Xhemollari parashtroi dhe deklaroi ndër të tjera se në këtë aktivitet janë përdorur burime publike, konkretisht Spitali Rajonal Lezhë. Në kushtet ku Drejtuesi Politik i Qarkut, siç cilësohet në postimin e bërë nga institucioni, Ministria e Shëndetësisë, kryetari i bashkisë Lezhë dhe deputeti i Partisë Socialiste së Shqipërisë, vizitojnë një aset publik, ku kryejnë një veprimtari publike dhe promovojnë investimet e kryera dhe ato që do të kryhen në të ardhme. Investime të cilat dalin përtej qytetit të Lezhës dhe shkojnë në nivel qarku dhe në nivel politik.

Në seancën publike, përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale deklaroi ndër të tjera se raportimi i kësaj veprimtarie është bërë në kohë reale nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, brënda afateve ligjore dhe e fakton këtë nëpërmjet provës shkresore. Po ashtu përfaqësuesi ka deklaruar se fondet për këtë investim janë vënë në dispozicion përpara datës 13 Janar 2023, afat i cili përkon me periudhën zgjedhore. Për këtë arsye kërkon rrëzimin e pretendimve të denoncuesit.

Nga verifikimi i të gjitha fakteve dhe provave lidhur me sa më sipër, pas verifikimit edhe të materialeve filmike të marra nga denoncimi, por edhe të pretendimeve të palëve në seancë, rezultoi se në ndërfaqen e raportimeve Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është raportuar kryerjen e aktivitetit objekt denoncimi më datë 2.2.2023, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Për sa i përket veprimtarive publike, në kuptim të nenit 3, pika 1.1, nënpika "b", të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, veprimtari të ndaluara për tu promovuar janë veprimtaritë publike, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve. Në këto kushte, veprimtaria e zhvilluar nga pala e denoncuar në këtë proces nuk përbën veprimtari të ndaluar për t'u promovuar.

Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve dhe nga këqyrja e materialit filmik, nuk rezultoi në këtë aktivitet të janë mbajtur deklarime apo thirrje elektorale nga asnjë prej pjesëmarrësve, por deklarimet kanë të bëjnë me zhvillimin e politikave e të strategjive shtetërore në fushën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Ogerta Manastirliu Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zj. Joana Duro, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, z. Leon Kaza, Drejtor i Spitalit Rajonal Lezhë dhe z. Pjerin Ndreu kryetar i bashkisë Lezhë vlerësoj se nuk përbën në shkellje të neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

- 17- Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur denoncim nëpërmjet shkresës datë 22.02.2023, administruar me shkresën nr.1097 prot., datë 24.02.2023, **regjistruar me nr. 110 ID**, me denoncues Partia Demokratike, Dega Elbasan. Denoncuesi pretendon se Bashkia Elbasan, Ujësjetllës Kanalizime Elbasan, Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Zyra Vendore Arsimore, Uzina e Lëndëve Plasëse Mjekës, Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Elbasan, Drejtoria Rajonale e Punësimit Elbasan, kanë kryer veprimtari të ndaluar në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Sipas denoncuesit subjektet e mësipërme kanë kryer punësime me kontrata afatshkurtëra për qëllime politike.

Me nisjen e hetimit administrativ, më datë 6.2.2023, bashkisë Elbasan, Ujësjetllës Kanalizime Elbasan; Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike; Zyra Vendore Arsimore Elbasan; Uzinës së Lëndëve Plasëse Mjekës; Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan; Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Elbasan si dhe Drejtorisë Rajonale të Punësimit Elbasan, i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Bashkia Elbasan, më datë 10.3.2023 bën me dije se: *“...Për periudhën nga data 13 Janar 2023 deri me 24 Shkurt 2023, janë punësuar në total 88 punonjës, në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 167, datë 22.12.2022... Punësimet për kontratat me afat janë rastet e zëvendësimeve të punonjëseve me leje lindje dhe punonjës sezonale me kohë të pjesshme kryesisht pranë Agjencisë së Shërbimeve Publike dhe Qendrës Ekonomike të Arsimit (instruktur part-time për qendren e fëmijëve). Punësimet për kontratat pa afat janë punësime në vende vakante sipas strukturës së miratuar nga Këshilli Bashkiak më datë 22.12.2022. Referuar nenit 91, pika 3, të Kodit Zgjedhor ndalohen punësimet 4 muaj para datës së zgjedhjeve në rastin e zgjedhjeve qendrore. Në rastin e zgjedhjeve lokale nuk ka ndalime të tilla dhe për më tepër nga Komisioneri për Sherbimin Civil jemi njoftuar për të mos bërë punësime nga data 1.3.2022, por duke pasur hapësira për emërime emergjente në vende vakante në permbushje të misionit të institucionit publik.”*

Veprimtaria do të konsiderohej e ndaluar nëse do të ishte kryer “gjatë fushatës zgjedhore” dhe në kundërshtim me rastet e përligjura.

Neni 77, pika 1, e Kodit Zgjedhor përcakton se fushata zgjedhore fillon 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 (njëzetë e katër) orë para datës së zgjedhjeve.

Për sa më sipër vlerësoj se nuk mund të vazhdoj shqyrtimin administrativ pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, denoncimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

18- Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a, më datë 10.3.2023 bën me dije se: *"Në vijim të bashkëpunimit, dhe bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 "Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe pëpunimit të ujërave të ndotura", marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetllës- Kanalizime Elbasan Sh.a datë 22.7.2022, lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh është krijuar shoqëria e re aksionare "Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a". Përsa më sipër, pjesë e administrimit të shoqërisë rajonale është dhe ujësjetllësi Elbasan. Ju njoftoj se aktualisht mbaj funksionin e administratorit të shoqërisë UK-Elbasan me Nipt: L43121201L deri në përfundim të likuidimit të kësaj shoqërie. Shoqëria UK-Elbasan, nuk ka asnjë punonjës tjetër të regjistruar përveç administratorit."*

Në vijim të hetimit administrativ u njoftua përfaqësuesi i Ujësjetllës Kanalizime Elbasan, për të marrë pjesë në seancën publike dëgjimore të datës 16 Mars 2023. Gjatë seancës, përfaqësuesi u shpreh se që në datën 1 Janar 2023 Shoqëria e Ujësjetllës Kanalizime Elbasan, I ka të gjitha të drejtat për punësim , që pas krijimit të Shoqërisë Rajonale të Ujësjetllës Elbasan pasi drejtoria e Elbasanit dhe admnistratori i saj nuk i ka më këto të drejtat. Aktualisht rezulton që vetëm administratori të jetë punonjës i kësaj Shoqërie. Nuk kemi asnjë kompetencë për emërimë punësimesh , të cilën e vertetojme edhe nga lista-pagesa e kontributeve që vetem administrator është I punësuar aktual, jemi për cështje likuidimi deri në mbylljen e bilancit dhe shkrirjen e shoqërisë.

Veprimtaria do të konsiderohej e ndaluar nëse do të ishte kryer "gjatë fushatës zgjedhore" dhe në kundërshtim me rastet e përligjura.

Neni 77, pika 1, e Kodit Zgjedhor përcakton se fushata zgjedhore fillon 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 (njëzetë e katër) orë para datës së zgjedhjeve.

Për sa më sipër vlerësoj se nuk mund të vazhdoj shqyrtimin administrativ pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, denoncimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

19- Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, më datë 9.3.2023, bën me dije se: *"Për periudhën 13.1.2023-24. 2.2023, pranë Drejtorisë Rajonale Elbasan janë emëruar vetëm 2*

(dy) punonjës me kontratë pa afat, ndërkohë që për të njëjtën periudhë janë krijuar 5 vende vakante për shkak të largimeve nga puna”.

Në vijim të hetimit administrativ u njoftua përfaqësuesi i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, për të marrë pjesë në seancën publike dëgjimore të datës 16 Mars 2023. Gjatë seancës, përfaqësuesi u shpreh se OSHEE-ja nuk është punëdhënëse, drejtori i drejtorisë rajonale nuk lidh kontrata pasi nuk ia lejon procedura. Nga përgjigja e drejtorisë së Burimeve njerëzore në Tiranë, ne perjudhën në fjalë janë bërë vetëm dy punësime me afat të pacaktuar, për të plotësuar vendet vakante, nuk ka asnjë kontratë me perjudha të caktura 3, 5 apo 6 mujore sic pretendohet. Mbi modalitetet e shpalljes dhe të njoftimit duhet që t'i drejtoheni Drejtorisë së Burimeve Njerëzore pranë OSHEE group Sh.a Tiranë.

Veprimtaria do të konsiderohej e ndaluar nëse do të ishte kryer “gjatë fushatës zgjedhore” dhe në kundërshtim me rastet e përligjura.

Neni 77, pika 1, e Kodit Zgjedhor përcakton se fushata zgjedhore fillon 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 (njëzetë e katër) orë para datës së zgjedhjeve.

Për sa më sipër vlerësoj se nuk mund të vazhdoj shqyrtimin administrativ pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, denoncimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

20- Zyra Vendore Arsimore Elbasan, me shkresën nr. 243 prot., më datë 13.3.2023, bën me dije se: *“bazur në ligjin nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 7961, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Urdhërin e Ministrit të Sportit dhe Rinisë nr. 31 datë 28.01.2020, Për Miratimin e Rregullores për Funkcionimin e Institucioneve Arsimore”, Udhëzimin Nr.12 datë 10.6.2021, “Për procedurat e pranimit dhe të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në IAP” dhe renditjen e portalit “Mësues për Shqipërinë”, ZVAP Elbasan ka punësuar 19 mësues në institucionet arsimore nën juridiksionin e saj, nga të cilët 18 mësues me kontratë me afat të caktuar dhe 1 mësues definitiv për periudhën 13.1.2023 deri më 24.02.2023. Punësimet kanë ardhur si pasojë e daljes në pension, largimit me dëshirë, raporteve mjekësore dhe lejeve të lindjes. Theksojmë se, punësimi i mësuesve është bërë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi duke repektuar në menyrë rigorozë Udhëzimin Nr.12 datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit dhe të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në IAP” dhe renditjen e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’... Proçesi i punësimit të mësuesve është kryer për të siguruar një proces mësimor të rregullt dhe cilësor duke mos cënuar të drejtën për t’u arsimuar të nxënësve që mësojnë në Institucionet Arsimore të sipërpërmendura.”*

Në vijim të hetimit administrativ u njoftua përfaqësuesi i Zyrës Vendore Arsimore Elbasan, për të marrë pjesë në seancën publike dëgjimore të datës 16 Mars 2023. Gjatë seancës, përfaqësuesi theksoi faktin që punësimet në Arsimin Parauniversitar, funksionojnë në bazë të portalit “Mësues për Shqipërinë”. Të gjitha punësimet e kryera nuk janë mbi organiken, janë zëvendësime, raporte dhe leje lindje për t’ju afruar shërbimin nxënësve të Arsimit

Parauniversitar.Procedura e ndjekur në këto punësime , zëvensësime raporte , leje lindje apo dalje në pension është në bazë të Portalit “Mësues për Shqipërinë” mbi bazën e kërkesës së drejtorit të Institucioneve Arsimore dhe mbi bazën e renditjeve të pikëve për çdo kandidat që kërkon të punesohet në arsimin parauniversitar .

Bazuar në nenin 91 të Kodit Zgjedhor , i konsiderojmë këto punësime të përligjura pasi ofrohet një e drejtë Kushtetuese për arsimimin e Fëmijëve.

Veprimtaria do të konsiderohej e ndaluar nëse do të ishte kryer “gjatë fushatës zgjedhore” dhe në kundërshtim me rastet e përligjura.

Neni 77, pika 1, e Kodit Zgjedhor përcakton se fushata zgjedhore fillon 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 (njëzetë e katër) orë para datës së zgjedhjeve.

Për sa më sipër vlerësoj se nuk mund të vazhdoj shqyrtimin administrativ pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, denoncimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

21- Uzina e Lëndëve Plasëse Mjekës, më datë 6.3.2023 bën me dije se: “...institucioni, Uzina e Lëndëve Plasëse Mjekës Elbasan, nuk ka bërë asnjë punësim gjatë periudhës së përmendur (data 13 Janar 2023-24 Shkurt 2023).

Veprimtaria do të konsiderohej e ndaluar nëse do të ishte kryer “gjatë fushatës zgjedhore” dhe në kundërshtim me rastet e përligjura.

Neni 77, pika 1, e Kodit Zgjedhor përcakton se fushata zgjedhore fillon 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 (njëzetë e katër) orë para datës së zgjedhjeve.

Për sa më sipër vlerësoj se nuk mund të vazhdoj shqyrtimin administrativ pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, denoncimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

22- Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan, me email-in e datës 9.3.2023 ka përcjellë shkresën nr. 354 prot., datë 9.3.2023, me të cilën bën me dije se: “...Institucioni yne, lidhur me procedurën e punësimeve, e ushtron aktivitetin e tij në mbështetje të VKM nr.419, datë 04.07.2018 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor", Urdhërit nr. 18, datë 17.01.2019 "Për Miratimin e Rregullores së Brendshme për Mënyrën e Funksionimit dhe të Organizimit të Operatorit të Kujdesit Shëndetësor ", të Ministrisë së Shëndetësisë Mbrojtjes Sociale, si edhe Udhëzimit nr. 514, datë 18.09.2022, Për disa shtesa dhe ndryshime të Udhëzimit nr. 673, dt.02.10.2019, "Për procedurat e punësimit të punonjësve të Administratës në OSHKSH, Spitale Rajonale e Bashkiake dhe NJVKSH". Përsa i përket pretendimeve në ankim: 1. Punësime të kryera në DROSHKSH Elbasan nga data 13 Janar 2023 deri në datë 24 Shkurt 2023, për punonjësit me kontratë pa afat ose me kohë të caktuar (3-mujore ose 6-mujore). Për këtë periudhë kohore institucioni nuk ka kryer asnjë procedurë

punësimi. 2. Numri i punësimeve të kryera përgjatë periudhës 13 Janar 2023 deri në 24 Shkurt 2023. Duke qenë se nuk kemi kryer asnjë procedurë punësimi, rrjedhimisht nuk kemi asnjë punonjës të punësuar.”

Veprimtaria do të konsiderohej e ndaluar nëse do të ishte kryer “gjatë fushatës zgjedhore” dhe në kundërshtim me rastet e përligjura.

Neni 77, pika 1, e Kodit Zgjedhor përcakton se fushata zgjedhore fillon 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 (njëzetë e katër) orë para datës së zgjedhjeve.

Për sa më sipër vlerësoj se nuk mund të vazhdoj shqyrtimin administrativ pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, denoncimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

23- Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Elbasan më datë 7.3.2023 bën me dije se: “...në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Elbasan nuk ka patur emërimet gjatë periudhës 13.1.2023 deri më 24.2.2023.”

Veprimtaria do të konsiderohej e ndaluar nëse do të ishte kryer “gjatë fushatës zgjedhore” dhe në kundërshtim me rastet e përligjura.

Neni 77, pika 1, e Kodit Zgjedhor përcakton se fushata zgjedhore fillon 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 (njëzetë e katër) orë para datës së zgjedhjeve.

Për sa më sipër vlerësoj se nuk mund të vazhdoj shqyrtimin administrativ pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, denoncimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

24- Drejtoria Rajonale Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Elbasan, më datë 8.3.2023 bën me dije se: “Referuar urdhrin të Kryeministrit Nr.80, datë 30.12.2022, “Për disa ndryshime në Urdhrin nr.172, dt.24.12.2019, Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKPA-s” i ndryshuar, janë reflektuar ndryshimet përkatëse të kategorisë për specialistët e sektorëve vendor nga kategoria IVC në IVB. -Drejtorja Rajonale e AKPA Elbasan operon me sistemin HRMIS, për efekt reflektimi të ndryshueshmërisë së kërkuar tek sistemi HRMIS duhet të fshiheshin punonjësit të cilët i prekte ky ndryshim dhe të ri- hidheshin në sistem me ndryshimet përkatëse. -Nëse bëni verifikimin pranë drejtorisë së tatimeve, mund të shihni që emrat e 9-të presonave të cilët janë ri-deklaruar më datë 13. 1.2023, janë të njëjta - Ju njoftoj gjithashtu se: Nga të gjithë punonjësit e zyrave të punësimit Elbasan, emërimi më i ri i fundit është më 17.11.2022 dhe më i vjetri 1.12.1992, 1994, 1995 etj. Gjithashtu ju bëjmë me dije se: Institucioni i zyrës së punës nuk punëson staf të jashtëm me afate kohore 3-6 muaj.”

Në vijim të hetimit administrativ u njoftua përfaqësuesi i Agjensisë Kombëtare të Punësimit, për të marrë pjesë në seancën publike dëgjimore të datës 16 Mars 2023. Gjatë seancës, përfaqësuesi u shpreh se Institucioni nuk ka staf të përkohshëm, por që në fakt është vetë Agjencia e cila implementon programe nxitjesh punësimi, të cilat akoma nuk janë konfirmuar për vitin 2023, që do të thotë se nuk janë punësime, por programe të ndryshme në fushën e integritetit për çdo individ, programe këto të përvitshme. Për sa i përket ndryshimeve që i janë bërë kategorisë për punonjësit ekzistent, i pari është i punësuar që në vitin 1992, dhe i fundit është punësuar në 19.11.2022, pra rezulton se nuk ka asnjë lloj punësimi të ri.

Referuar vendimit të Kryeministrit, për disa rregullime që lidhen me mirëfunksionimin e Agjensisë Kombëtare të Punësimit i datës 30.12.2022 me nr urdhëri 210 dhe urdhërit nr 80 datë 30.12.2022 të Kryeministrit, për disa ndryshime në urdhërin 172 datë 24.12.2019, për miratimin e strukturës dhe organikës së AKPA-së i ndryshuar, ku citohet ndryshimi i kategorisë nga 4c në 4b të individëve të punësuar, sistemi financiar i cili është i lidhur me HMRISI, në momentin që ndërrohet kategoria, duhet të fshihen punonjësit që janë ekzistent dhe të rikthehen me kategorinë e re. Nuk mund të përfitohet kategoria pa u hequr më parë nga sistemi. Kontratat e personave që nga ristrukturimi i Agjenciës nga SHPK në Agjencia Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive fillojnë nga data 16.12.2020, ndërsa për ndryshimin e kategorisë, efektet financiare fillojnë nga 1.9.2022 me urdhër të Kryeministrit, Struktura e Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive në drejtorinë Elbasan është e përbërë prej 24 individësh aktualisht, dhe nuk ka asnjë ndryshim. Mund të bëhen verifikime në DPT ku shumë qartë shihen emrat e personave ekzistent, janë po të njëjtët emra të personave që kanë qënë përpara ndryshimit të kategorisë. Kjo është bërë vetëm me Zyrat Vendore të cilat kishin një kategori të mangët.

Veprimtaria do të konsiderohej e ndaluar nëse do të ishte kryer "gjatë fushatës zgjedhore" dhe në kundërshtim me rastet e përligjura.

Neni 77, pika 1, e Kodit Zgjedhor përcakton se fushata zgjedhore fillon 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 (njëzetë e katër) orë para datës së zgjedhjeve.

Për sa më sipër vlerësoj se nuk mund të vazhdoj shqyrtimin administrativ pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, denoncimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj:

- a) Zj. Xheni Kita, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Korçë;
- b) Z. Shkëlqim Beqiraj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Patos;
- c) Z. Genci Floqi person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Maliq;
- d) Z. Etjola Çato person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës;
- e) Zj. Elona Boriçi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionin e Entit Kombëtar të Banesave;
- f) Z. Mustafa Çarçiu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Belsh;
- g) Z. Dëfrim Korbi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kukës;
- h) Z. Nertil Nebiaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Gjirokastrë;
- i) Zj. Diana Dervishi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionin e Autoritetit të Konkurrencës;
- j) Z. Alban Dokushi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tiranë;
- k) Z. Erjon Lalaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kavajë;
- l) Zj. Erisa Qalliu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Lushnjë
- m) Zj. Manushaqe Gojka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
- n) Zj. Ermelinda Pema, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Ministrit të Shtetit për Standardet dhe Shërbimet
- o) Z. Flauers Shoshi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta;
- p) Zj. Ogerta Manastirliu, Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- q) Z. Gledian Llatja, Kryetar në Bashkinë Elbasan;
- r) Z. Çelik Leka, Drejtor i Përgjithshëm pranë Ujësjetllës Kanalizimeve Elbasan;
- s) Z. Irland Sina, Drejtor i Përgjithshëm pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Elbasan;
- t) Z. Ermir Çela, Drejtor

pranë

Zyrës Vendore Arsimore, Elbasan;

Data: 24 Mars 2023

Nr: 199
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike”

- u) Z. Arben Asllanaj, Drejtor i Përgjithshëm pranë Uzinës së Lëndëve Plasëse Mjekës, Elbasan;
 - v) Zj. Ermira Urupi, Drejtor i Përgjithshëm pranë Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Elbasan;
 - w) Z. Julian Senia, Drejtor i Përgjithshëm pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Elbasan;
 - x) Zj. Marsida Hyseni, Drejtor i Përgjithshëm pranë Drejtorisë Rajonale të Punësimit dhe Aftësivë, Elbasan.
2. Tërheqje vëmendje për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
 3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI